

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
Prorrjet Sh.p.k**

Ne Tirane, sot me datë 03/10/2024 **Aleksandër Kërçani**, person me shtetësi shqipëtare, i datëlindjes 26/09/1966 mbajtës i kartës së identitetit me Nr.**G60926013Q**, i cili me zotësi të plotë juridike per të vepruar, nenshkruan kete Akt Themelimi te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **Prorrjet Sh.p.k**.

**Neni 1
Forma e shoqerise**

Ortaku themelon një shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, ne kuptimin qe pergjegjesia e tij eshte e kufizuar deri ne shumen e kapitalit te derdhur, pa iu njohur asnje pergjegjesi tjeter.

**Neni 2
Emertimi i shoqerise
Emertimi i shoqerise eshte Prorrjet Sh.p.k**

**Neni 3
Baza juridike**


Shoqeria e ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe ne perputhje me dispozitat e Statutit e Aktit te Themelimit.

**Neni 4
Objekti i veprimtarise**

4.1 Veprimtaria e Shoqerisë **Prorrjet Sh.p.k** do të ketë për objekt :

- **Programime dhe shërbime kompjuterike.**

4.2 Shoqëria mund te kryeje cdo lloj veprimtarie tjeter qe është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe qe siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, mund të kryejë cdo operacion prodhimi, tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive dhe



krijimin e shoqërive të tjera brenda dhe jashtë vendit.

4.3 Shoqëria, me vendim të Administratorit mund të lidhë marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo sipërmarrje të tjera, si dhe të kryejë cdo veprim tregtar që konsiderohet i nevojshëm me qëllim arrijtjen e objektit të veprimtarisë së saj.

4.4 Për të realizuar qëllimet e saj Shoqëria mund të sigurojë dhe perdore financime nga ortakët, nga vende të tjera ose nga institucione financiare vendase ose të huaja.

4.5 Objekti i shoqërisë mund të ndryshojë, të zgjerohet ose të pakesohet në baze të vendimit të administratorit.

Neni 5 Selia

Selia e Shoqërisë Prorrjet Sh.p.k është në adresën:

Rruga Unaza e Re pranë mbikalimit, Tiranë banesa me numer 56 kati i dytë Tiranë.

Shoqëria mund të hapë dege dhe filiale brenda dhe/ose jashtë vendit.

Neni 6 Kohezgjatja

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë për një periudhë të pacaktuar kohore.

Neni 7 Kapitali i shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë Prorrjet Sh.p.k është 100 000 (njqindmije) Leke, dhe zoterohet 100% nga administratori Aleksandër Kërçani, person me shtetësi shqiptare, i datëlindjes 26/09/1966 mbajtës i kartës së identitetit me Nr.G60926013Q.

Neni 8 Administrimi

Shoqëria do të administrohet nga 1 Administrator.

Administrator i shoqërisë do të jetë:

1. Aleksandër Kërçani, person me shtetësi shqiptare, i datëlindjes 26/09/1966 mbajtës i kartës së identitetit me Nr.G60926013Q.



Neni 9
Viti financiar

Vitet financiare perputhen me vitin kalendarik. Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbyllet me 31 Dhjetor te cdo viti kalendarik. Perjashtimisht, viti i pare financiar do te filloje nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar dhe do te mbyllet ne fund te vitit perkates.

Neni 10
Te ardhurat neto

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakeve themelues te shoqerise ne raport me kuotat e tyre ne kapitalin fillestar. Te ardhurat qe do te rezultojne ne fund te mbylljes se cdo ushtrimori, ne perputhje me parashikimet e statutit dhe pas pagimit te tatimeve, dhe rezerves se domosdoshme, te konkretizuara ne bilance, mund te ndahen ndermjet ortakeve ne raport me pjeset qe ata zoterojne ne kapitalin e shoqerise.

Neni 11
Juridiksioni

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise, do te zgjidhen me mirekuptim. Ne rast te kundertet, kompetente per zgjidhjen e tyre jane Gjykatat Shqiptare.

Ky Akt themelimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar , eshte hartuar ne 5 kopje ne gjuhen Shqipe dhe pasi lexohet, nenshkruhet rregullisht nga ortaket themelues.

Ortaku i vetem
Aleksandër Kërçani

Aleksandër
Kërçani

